



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 94

2003

Nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.93, datë 30.10.2003	Për zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.....	4143
Vendim i KM nr.730, datë 6.11.2003	Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill.....	4143
Vendim i KM nr.731, datë 6.11.2003	Për përcaktimin e njërive të shoqërisë anonime "ALBPETROL", që nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë.....	4146
Vendim i KM nr.732, datë 6.11.2003	Për strukturën dhe nivelet e pagave të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.....	4147
Vendim i KM nr.733, datë 6.11.2003	Për disa ndryshime në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave "Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.....	4148
Vendim i KM nr.740, datë 6.11.2003	Për mënyrën e organizimit dhe procedurën e votimit, për përcaktimin e përfaqësueshmërisë së organizatave të punëmarrësve.....	4148

Vendim i KM nr.741, datë 6.11.2003	Për procedurën e pajtimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të zyrave shtetërore të pajtimit.....	4150
Vendim i KM nr.742, datë 6.11.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë"	4151
Vendim i KM nr.744, datë 6.11.2003	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për asistencën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore.....	4152
Vendim i GJK nr.31, datë 19.11.2003	Me objekt kushtetutshmërinë e kërkesës për zhvillimin e referendumit për shfuqizimin e neneve 4 e 6 të ligjit nr.8889, datë 25.4.2002 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", në bazë të nenit 152, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 129, paragrafi 2, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.....	4160
Udhëzim i KM nr.3, datë 10.7.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave "Për prokurimin publik", i ndryshuar.....	4163
Udhëzim i KZQV nr.19, datë 18.11.2003	Për procedurën e hedhjes së shortit për ndarjen e mandatit të fundit për këshillat vendorë midis subjekteve që kanë numër të barabartë votash.....	4168
Vendim i KKRT nr.184/1, datë 14.11.2003	Me subjekt rinovimin e licencës së subjektit radiofonik "Stinët"	4169
Vendim i KKRT nr.188, datë 14.11.2003	Me subjekt rinovimin e licencës së subjektit radiofonik "Saranda".....	4170
Vendim i KKRT nr.189, datë 14.11.2003	Me subjekt rinovimin e licencës së subjektit radiofonik "Ngjallja".....	4171
	<i>Vendim i shkurtuar për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Eno Thanas.....</i>	4171
	<i>Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Feçorr Malaj.....</i>	4171
	<i>Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Havako Zotaj.....</i>	4171
	<i>Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Xheke Dakaj.....</i>	4171

VENDIM
Nr.93, datë 30.10.2003

**PËR ZGJEDHJEN E TRE ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT
RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 88 e 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të zgjedhë në detyrën e anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve:

1. Shyqyri Meka
2. Dule Dervishi
3. Anila Kaçupi

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.730, datë 6.11.2003

**PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS DHE PËR CAKTIMIN E
PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË KËTË KËSHILL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 6, 9 e 10 të nenit 200 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Punës, në vijim KKP, funksionon pranë Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

2. KKP-ja zhvillon këshillime, merr vendime me konsensus dhe i bën rekomandimet përkatëse Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

3. KKP-së, nga organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, si dhe nga administrata publike, t'i vihen në dispozicion të gjitha informacionet dhe të dhënat e nevojshme, që kanë lidhje me objektin e funksionimit të saj për zhvillimin e këshillimeve.

4. Përfaqësimi i organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në KKP përcaktohet në mbështetje të vlerësimit të treguesve të mëposhtëm:

Për organizatat e punëmarrësve:

a) numrit të anëtarëve, i vërtetuar nga deklaratimet personale, kuotizacionet ose vërtetimet noteriale;

b) numrit të kontratave kolektive të punës të lidhura dhe numrit të punonjësve të mbuluar nga këto kontrata;

c) numrit të degëve/profesioneve dhe/ose organizatave territoriale;

ç) mundësisë për t'u angazhuar në bisedime për realizimin e marrëveshjeve kolektive dhe zgjidhjes së konflikteve nëpërmjet ndërmjetësimit;

d) anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Për organizatat e punëdhënësve:

a) numrit të ndërmarrjeve të anëtarësuar;

b) numrit të punonjësve të punësuar në ndërmarrjet e anëtarësuar;

c) numrit të degëve/profesioneve dhe/ose organizatave territoriale;

ç) buxhetit të organizatës për çështjet shoqërore;

d) mundësisë së organizatës për t'u angazhuar në bisedime për realizimin e marrëveshjeve kolektive dhe zgjidhjes së konflikteve nëpërmjet ndërmjetësimit;

dh) anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

5. Janë anëtarë të KKP-së këta përfaqësues të Këshillit të Ministrave:

- Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale,

- Ministri i Financave,

- Ministri i Shëndetësisë,

- Ministri i Arsimit dhe i Shkencës,

- Ministri i Drejtësisë,

- Ministri i Ekonomisë,

- Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës.

Kandidatët e KKP-së, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, janë zëvendësministrat përkatës.

6. Përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, anëtarë të KKP-së, caktojnë përkatësisht kryetarët e palëve, të cilët janë edhe nënkryetarë të KKP-së.

7. Kryetari i KKP-së është Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale.

Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të KKP-së janë:

a) të drejtojë mbledhjet e KKP-së;

b) të miratojë rendin e ditës, raportin përfundimtar të mbledhjeve, si dhe programin vjetor të KKP-së, pas mirëkuptimit me palët;

c) të informojë Këshillin e Ministrave për rekomandimet e KKP-së, si dhe për mendimet e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve.

8. KKP-ja mbledhet, në përputhje me programin e miratuar prej tij ose me kërkesën me shkrim të çdo pale, drejtuar kryetarit të KKP-së, sipas përcaktimit të bërë në rregulloren e brendshme të funksionimit.

9. Anëtarët e KKP-së, për çështjet që do të diskutohen, kanë të drejtën e këshillimit paraprak dhe e shprehin qëndrimin e tyre, nëpërmjet kryetarit të palës.

Vetëm në rastet kur palët shprehen dakord, atëherë mund t'i rekomandohet Këshillit të Ministrave një projektakt ligjor ose nënligjor.

10. Pranë KKP-së krijohen dhe funksionojnë komisionet e specializuara tripalëshe, të përhershme, si më poshtë vijojnë:

a) komisioni juridik,

b) komisioni i punësimit dhe i formimit profesional,

c) komisioni i pagave dhe i pensioneve,

ç) komisioni i kushteve të punës, shëndetit dhe sigurimit në punë,

d) komisioni i ekonomisë dhe i financës.

11. Komisionet e specializuara, tripalëshe, të përhershme, kanë për objekt të shqyrtojnë çështje për fushat e tyre të kompetencës dhe t'i transmetojnë mendimet dhe përfundimet e këshillimeve KKP-së, për:

a) orientimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushat e veprimtarisë së tyre;

b) projektligjet dhe projektvendimet e Këshillit të Ministrave, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre;

c) çështjet për të cilat KKP-ja iu është drejtuar atyre për konsultim dhe mendim.

Për arritjen e objektivave, çdo komision mund të angazhojë specialistë të kualifikuar.

12. Komisionet e specializuara tripalëshe, të përhershme kryesohen nga kryetari dhe kanë në përbërje më shumë se 8 anëtarë. Përbërja e tyre përcaktohet nga KKP-ja.

13. Kryetarët e komisioneve të specializuara, tripalëshe, të përhershme caktohen nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, brenda administratës së kësaj ministrie, në nivelin e drejtorit të drejtorisë, sipas fushave që ata mbulojnë.

Anëtarët e komisioneve, përfaqësues të institucioneve shtetërore, caktohen nga titullarët e tyre.

14. Mënyra e organizimit dhe përgatitja e dokumentacionit të mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Punës përcaktohen në rregulloren e brendshme të miratuar prej tij.

15. Për funksionimin e KKP-së, në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale, ngrihet sekretariati, i përbërë nga tre sekretarë, të cilët janë nëpunës të administratës të kësaj ministrie, respektivisht nga një për çdo palë të përfaqësuar në këtë këshill. Për emërimin e sekretarëve të KKP-së merret dhe mendimi i partnerëve socialë.

16. Buxheti i pavarur i KKP-së përbëhet nga:

- a) fondi i dhënë nga buxheti i shtetit për Këshillin Kombëtar të Punës;
- b) kontributet e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve;
- c) donacione të ndryshme.

17. Fondi i dhënë nga buxheti i shtetit për Këshillin Kombëtar të Punës të përdoret, kryesisht, për përballimin e shpenzimeve të mbledhjeve të KKP-së, komisioneve të specializuara, të përhershme të tij, funksionimin e zyrave shtetërore të pajtimit, si dhe për organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca tripalëshe.

18. Fondi i mbledhur nga kontributet e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve të përdoret për financimin në masën 50 për qind të shpenzimeve, që parashikohen për kryerjen e studimeve, seminareve për çështjet në interes të këtyre organizatave, si dhe veprimtari të tjera brenda dhe jashtë vendit, të ngjashme me to.

19. KKP-ja bën miratimin paraprak të projektbuxhetit vjetor dhe nëpërmjet Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale ia propozon atë për miratim Këshillit të Ministrave.

20. Shpërblimi i anëtarëve të KKP-së, për çdo mbledhje, është në masën 5 për qind të pagës mujore të Ministrit.

Shpërblimi i anëtarëve të komisioneve të specializuara, për çdo mbledhje, është në masën 5 për qind të pagës së drejtorit të drejtorisë në ministri.

21. Kandidatët e KKP-së, në rastet kur zëvendësojnë anëtarët, përfitojnë shpërblimin sipas pikës 20 të këtij vendimi.

22. Vendimi nr.379, datë 20.5.1996 i Këshillit të Ministrave "Për Këshillin Kombëtar të Punës dhe të Çështjeve Sociale", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.731, datë 6.11.2003

PËR PËRCAKTIMIN E NJËSIVE TË SHOQËRISË ANONIME "ALBPETROL", QË NUK DO TË KONSIDEROHEN PJESË TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shoqërinë "Albpetrol" sh.a., nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë njësitë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Njësitë e përcaktuara në pikën 1 t'i nënshtrohen privatizimit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E NJËSIVE TË "ALBPETROL" SHA, QË NUK DO TË VLERËSOHEN PJESË TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË

1. Stacionet e pompimit të naftës: Gostimë (Elbasan), Uji i Ftohtë (Vlorë), Skrofotinë (Vlorë), Levan (Fier).

2. Stacionet për transportimin e gazit natyror: Kuçovë, Cërrik, Patos, Kavajë, Elbasan.

3. Tubacione transporti naftë (naftësjellës): Visokë-Fier (pjesë e tij); Kuçovë-Cërrik, VB Kuçovë-UPN Kuçovë.

4. Tubacione transporti nënproduktësh (benzinësjellës): Kuçovë-Zharrëz; Cërrik-Kuçovë.

5. Rezervuarë naftë: Visokë (2x20m³); Linas-Elbasan (1x250 m³); Kuçovë (1x20 m³).

6. Gazsjellësi Ballaj-Kavajë.

7. Centralet telefonikë të naftës (të qendrës së shërbimit elektrik-telefonik Patos): Fier, Visokë, Ballsh, Drenovë.

8. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Patos: ish-zyrat e sektorit të pestë Patos.

9. Ndërtesa në funksion të aktivitetit me qendrën e prodhimit të gazit Patos: godina e pompistëve të benzinës Ballsh; dhoma pune operatorësh Vlorë; banesë në Linas (Elbasan); godinë pikturë QTNG Patos; ndërtesa në ish-sektorin e gazit Divjakë (4 ish-fjetore dhe mensa me tallash betoni, dy fjetore me tulla, dy ish-banjo, zyrat e sektorit, magazina bashkë me shtesën, ofiçina) ndërtesa e sallës së kompresorit YSC; ndërtesa e qendrës së sektorit të gazit Ballaj; salla e pompave të ujit Povelçë; depo betoni në Finiq (Matomare).

10. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Kuçovë: ish-zyrat e sektorit të parë; tetoja e traktorëve sektori I; salla e riparimit të pompave të thellësisë-Kozare; godina e kompresorit të gazit sektori IV; zyrat e sektorit Arrëz; zyra e djegjes nëntokësore në Gegë; tetoja e rërës kuarcore; ish-zyrat e remontit kapital; zyrat e dispeçerisë së parkut; ish-banja-dushe; zyrat e vjetra të ndërmarrjes; ofiçina e riparimit të mjeteve të rënda Kuçovë; magazina rikupero (pranë parkut të naftës Kuçovë).

11. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Marinëz: zyrat e vjetra të ndërmarrjes; ndërtesë magazine; ndërtesa e ish-sektorit të gazit; godina e ish-muzeut Marinës.

12. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Sheqishtë: ish-zyrat e sektorit Kallm Verri.

13. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Ballsh: kabinë elektrike Hekal 22; ndërtesa e zyrës zona nr.2, Qafa e Vidhit.

14. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të rërës bituminoze: ish-zyrat; godina e laboratorit të uzinës së rërës bituminoze; ish-kabina elektrike e ofiçinës; ish-depo e dinamitit Kasnicë.

15. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në sektorin e administrimit dhe furnizimit materialo-teknik: depo e acideve Patos; karburanti i vjetër në Kuçovë.

VENDIM
Nr.732, datë 6.11.2003

**PËR STRUKTURËN DHE NIVELET E PAGAVE TË ENTIT RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE
TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të neneve 2 dhe 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar dhe të nenit 8 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullor të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Niveli i pagave të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura të jetë si më poshtë vijon:

a) Paga e kryetarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të jetë sipas kategorisë I-a, të klasës I, të lidhjeve nr.1 dhe 2 të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave.

b) Paga e anëtarit të këtij komisioni të njësohet me pagën e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme, sipas kategorisë II-a, të klasës II, të lidhjeve nr.1 dhe 2 të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave;

c) Pagat e punonjësve të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura të njësohen me pagat e funksioneve, të barasvlefshme në ministri.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

3. Pika 2 e vendimit nr.445, datë 16.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për ngritjen e Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.733, datë 6.11.2003

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE
RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Rrjetit rrugor kombëtar (pika 1) t'i shtohen edhe 23 km rrugë.
2. Lidhjes 1 "Rrjeti rrugor kombëtar", që i bashkëlidhet vendimit (pika 1), t'i shtohet ky emërtim:

"Drejtorisë së Mirëmbajtjes së Rrugëve, Durrës

Maminas-Hamallaj-Shën Pjetër 23 km rrugë interurbane, dytësore.

3. Në tabelën "Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale" (pika 4/1) të hiqet emërtimi: "Maminas-Hamallaj-Shën Pjetër."

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.740, datë 6.11.2003

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE PROCEDURËN E VOTIMIT, PËR
PËRCAKTIMIN E PËRFAQËSUESHMËRISË SË ORGANIZATAVE TË PUNËMARRËSVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 164 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punëdhënësi ose organizata e punëdhënësve, kur nuk e pranon vendimin e zyrës së pajtimit, ka të drejtë t'i kërkojë Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale organizimin e votimit të fshehtë për përcaktimin e përfaqësueshmërisë së organizatës ose organizatave të punëmarrësve.

2. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, me kërkesën e punëdhënësit ose të organizatave të punëdhënësve, urdhëron kryerjen e votimit brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

3. Në urdhrin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale për kryerjen e votimit duhet të përcaktohen:

- a) përbërja e komisionit të votimit;
- b) organizatat punëmarrëse, pretenduese për përfaqësueshmërinë;
- c) ndërmarrja, ndërmarrjet apo dega e caktuar ose pjesë e tyre, punëmarrësit e të cilave do të marrin pjesë në votim;
- ç) vendi ku do të kryhet votimi;
- d) data dhe ora e fillimit dhe e mbarimit të procesit të votimit.

4. Komisioni i votimit kryesohet nga kryetari dhe ka në përbërje:

- një përfaqësues të punëdhënësit ose të organizatës së punëdhënëseve;
- nga një përfaqësues për secilën organizatë të punëmarrësve, pjesëmarrëse në votim.

Ministri cakton kryetarin e komisionit të votimit, i cili është nëpunës i administratës së Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe anëtarët e komisionit, sipas propozimeve të punëdhënësit ose të organizatës së punëdhënëseve dhe të organizatave të punëmarrësve, pjesëmarrëse në votim.

5. Komisioni i votimit ngrihet, të paktën 20 ditë para datës së votimit.

6. Listat emërore të punëmarrësve, që marrin pjesë në votim, përgatiten nga punëdhënësi, i cili i vë ato në dispozicion të komisionit të votimit, të paktën 15 ditë para datës së votimit.

7. Për çdo organizatë punëmarrësish, pjesëmarrëse në votim, caktohet një numër. Kur disa organizata punëmarrësish përfaqësohen së bashku, atyre u caktohet një numër i vetëm.

8. Fletët e votimit përgatiten nga zyrat rajonale të punësimit, sipas formularit tip, të miratuar nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale.

9. Komisioni i votimit ndjek e vëzhgon procesin e shtypjes së fletëve të votimit, i administron ato dhe, para fillimit të votimit, verifikon nëse kutia e votimit është bosh dhe e vulos atë.

10. Komisioni i votimit duhet të marrë masa të nevojshme, për të siguruar paanësinë e punëmarrësit që voton, lehtësinë e votimit dhe fshehtësinë e votës.

11. Për sigurinë e rendit dhe të qetësisë në mjedisin e votimit ose rreth tij, komisioni i votimit mund të kërkojë ndihmën e organeve të rendit publik.

12. Punëmarrësi, që merr pjesë në votim, paraqitet pranë komisionit të votimit, në mjedisin e votimit, duke treguar dokumentin e identitetit.

Komisioni i votimit, pasi vërteton identitetin dhe përfshirjen e punëmarrësit në listën e votimit, e pajis atë me fletën e votimit. Punëmarrësi, i pajisur me fletën e votimit, futet në dhomën e fshehtë dhe vendos shenjën "X" mbi numrin e organizatës, së cilës i jep votën. Fleta e votimit vlerësohet e pavlefshme, nëse shenja është vënë në më shumë se një numër ose jashtë tij.

13. Pas përfundimit të votimit, komisioni hap kutinë e votimit dhe bën numërimin e fletëve të votimit. Në bazë të vlerësimit dhe numërimit të votave, komisioni harton procesverbalin e votimit, i cili duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e komisionit.

Në procesverbal duhet të shënohen, detyrimisht, numri i punëmarrësve votues, numri i votave për çdo organizatë punëmarrësish dhe numri i votave të pavlefshme.

Një kopje e procesverbalit të votimit i jepet punëdhënësit dhe nga një kopje u jepet përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve, pjesëmarrëse në votim.

14. Rezultatet e votimit shpallen 24 orë pas përfundimit të votimit, nga kryetari i komisionit të votimit. Organizata ose grupi i organizatave të punëmarrësve, që fiton shumicën e votave në krahasim me organizatat ose grupin e organizatave, pjesëmarrëse në votim, konsiderohet më e përfaqësuar.

15. Kur organizata punëmarrëse, pjesëmarrëse në votim, kundërshton rezultatet e votimit, ajo ka të drejtë të ankohet në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës, brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultateve të votimit.

16. Shpenzimet e votimit, përfshirë edhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit të votimit përballohen nga punëdhënësi. Shpërblimi i anëtarëve të komisionit është të paktën sa paga ditore e tyre, shumëzuar me ditët e pjesëmarrjes në komisionin e votimit, të vërtetuara nga kryetari i komisionit.

17. Kryetari i komisionit të votimit kërkon parapagimin e shpenzimeve të votimit, për infrastrukturën e votimit. Nëse parapagimi nuk bëhet në afatin e caktuar, votimi nuk kryhet. Në këtë rast komisioni i votimit, nëpërmjet kryetarit, i drejtohet Ministrisë për shtyrjen e datës së votimit.

18. Vendimi nr.314, datë 30.4.1996 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përfaqësueshmërisë në njësinë e bisedimit", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

4149

VENDIM
Nr.741, datë 6.11.2003

PËR PROCEDURËN E PAJTIMIT DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË ZYRAVE SHTETËRORE TË PAJTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4 dhe 5 të nenit 189 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranë Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale të funksionojë Zyra Kombëtare e Pajtitimit dhe pranë zyrave rajonale të punësimit të funksionojnë zyrat e pajtitimit, për pajtimin e konflikteve sociale.

2. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale ose organi administrativ i autorizuar prej tij, në rastin e dështimit të ndërmjetësit, brenda tri ditëve, njofton zyrën e pajtitimit.

3. Nëse palët, gjatë shqyrtimit të konfliktit në zyrën e pajtitimit, pajtohen, hartohet një procesverbal, i cili, pasi nënshkruhet prej tyre, merr fuqinë e kontratës kolektive, e detyrueshme për t'u zbatuar nga këto palë.

4. Në mungesë të një pajtimi të drejtpërdrejtë të palëve, gjatë debateve në seancat e shqyrtimit, zyra e pajtitimit propozon pajtimin e tyre.

5. Nëse njëra nga palët, pa arsye të justifikuara, nuk paraqitet në seancat e shqyrtimit të konfliktit, zyra e pajtitimit, pasi dëgjon palën e pranishme dhe mbledh të dhëna të nevojshme, ka të drejtë të propozojë pajtimin.

6. Nëse ky propozim nuk mund të bëhet pa dëgjuar palën, që nuk është e pranishme, zyra e pajtitimit ka të drejtë të vendosë për thirrjen e palëve në një seancë tjetër, brenda 20 ditëve.

7. Anëtarët e zyrës së pajtitimit duhet të votojnë për propozimin e pajtitimit, i cili vendoset me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës dhe, në rast barazimi votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

8. Kryetari i zyrës së pajtitimit njofton me shkrim palët për propozimin e pajtitimit dhe cakton një afat për të deklaruar, me shkrim, pranimin ose kundërshtimin e këtij propozimi.

9. Nëse palët e pranojnë dhe e nënshkruajnë propozimin e zyrës së pajtitimit, ky propozim merr fuqinë e kontratës kolektive, e detyrueshme për t'u zbatuar nga palët. Në rast të kundërt, kryetari i zyrës së pajtitimit, deklaron dështimin e pajtitimit të palëve në konflikt.

10. Kryetari i Zyrës Kombëtare të Pajtitimit dhe kryetarët e zyrave të pajtitimit përfitojnë një shpërblim mujor deri në 10 për qind të pagës mujore, përkatësisht, të drejtorit të drejtorisë në ministri dhe të drejtorit të zyrës rajonale të punësimit.

11. Anëtarët e Zyrës Kombëtare të Pajtitimit përfitojnë një shpërblim të barabartë me pagën ditore të drejtorit të drejtorisë, shumëzuar me ditët, në të cilat marrin pjesë në seancat e pajtitimit, të vërtetuara nga kryetari i zyrës.

12. Anëtarët e zyrave të pajtitimit përfitojnë një shpërblim të barabartë me pagën ditore të drejtorit të zyrës rajonale të punësimit, shumëzuar me ditët në të cilat marrin pjesë në seancën e pajtitimit, të vërtetuara nga kryetari i zyrës.

13. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të zyrave shtetërore të pajtitimit të përballohen nga buxheti i dhënë për Këshillin Kombëtar të Punës.

14. Vendimi nr.313, datë 30.4.1996 i Këshillit të Ministrave "Për zyrat e pajtitimit dhe arbitrimin", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.742, datë 6.11.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.692, DATË 13.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MASAT E VEÇANTA TË SIGURIMIT DHE TË MBROJTJES SË SHËNDETIT NË PUNË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 40 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1, 2/2, 2/3 dhe 2/4 me këtë përmbajtje:

"2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike.

2/2. Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat", i ndryshuar.

2/3. Mjekët e ndërmarrjes merren në punë si nëpunës të ndërmarrjes dhe varen drejtpërdrejt nga punëdhënësi. Punëdhënësi e njej mjekun me detyrat e shërbimit shëndetësor të ndërmarrjes dhe kërkon zbatimin e tyre, sipas legjislacionit të punës. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe mjekut të ndërmarrjes përcaktohen në bazë të kontratës së punës që lidhin palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2/4. Mjeku i ndërmarrjes ka këto detyra:

a) Këshillon punëdhënësin për problemet e mbrojtjes në punë, për shmangien e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale, si dhe për të gjitha çështjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;

b) vlerëson çështje të fiziologjisë së punës, të problemeve higjienike e sanitare, veçanërisht të ritmit e të kohës së punës, të organizimit të vendit të punës, të zhvillimit dhe të mjediseve të punës;

c) rekomandon çështje të ndryshimit të vendeve të punës për riintegrimin e të gjymtuarve në procesin e punës dhe të të sëmurëve me sëmundje profesionale, si dhe studion shkaqet e aksidenteve në punë e të sëmundjeve profesionale, duke i propozuar punëmarrësit masat për shmangien e tyre;

ç) kontrollon pranimin në punë të punëmarrësve, në përputhje me raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni medikologjor, në bazë të aftësive shëndetësore për procesin konkret të punës, si dhe organizon ekzaminimin periodik, shëndetësor, për të gjithë punonjësit, një herë në 6 muaj;

d) ndjek, në mënyrë të vazhdueshme, të sëmurët kronikë, bën konsulta me mjekët e familjes dhe specialistët, si dhe ndërhyr te punëdhënësi, që, në rast nevojë, të bëjë ndërrimin e vendit të punës;

dh) bashkëpunon me mjekun e sëmundjeve profesionale dhe repartet klinike të sëmundjeve profesionale, për diagnozën dhe trajtimin e të sëmurëve me sëmundje profesionale;

e) plotëson regjistrin e paaftësisë së përkohshme në punë, të aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale, si dhe, në bashkëpunim me punëdhënësin, denoncon pranë Inspektoratit të Punës rastet e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale."

2. Pikat 9 dhe 10 shfuqizohen.

3. Pas pikës 12 shtohen pikat 12/1, 12/2 dhe 12/3 me këtë përmbajtje:

"12/1. Marrja në punë e mjekut është e detyrueshme për të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave klasifikohet sipas vendimeve nr.459, datë 22.7.1998 "Për substancat e rrezikshme", nr.419, datë 4.8.2000 "Për objektet e rrezikshme" dhe nr.207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të

vështira ose të rrezikshme" të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga numri i të punësuarve.

12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

12/3. Mjeku i ndërmarrjes mban përgjegjësi sipas ligjit për pasojat, që mund të vijnë nga moszbatimi i detyrave të përcaktuara sipas pikës 2/4 të këtij vendimi."

4. Pas pikës 13 shtohen pikat 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

"14.Vendimi nr.449, datë 17.10.1992 i Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e shërbimit mjekësor në ndërmarrje", shfuqizohet.

15. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 744, datë 6.11.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR ASISTENCËN E NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE NË ÇËSHTJET DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për asistencën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË MBI ASISTENCËN E NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE NË ÇËSHTJET DOGANORE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, që në vijim do të referohen si Palë Kontraktuese:

duke marrë në konsideratë rëndësinë e vlerësimit të saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera dhe për të siguruar zbatimin e duhur nga administratat doganore të masave specifike të ndalimit, kufizimit dhe kontrollit;

duke marrë në konsideratë që shkeljet e ligjit doganor janë të dëmshme për interesat e tyre ekonomike, tregtare, fiskale, shoqërore, shëndetësore dhe kulturore;

duke njohur nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar në çështjet që lidhen me zbatimin e ligjeve të tyre doganore;

të bindur se veprimet e ndërmarra kundër shkeljeve doganore mund të jenë më efektive ndërmjet bashkëpunimit të ngushtë midis administratave doganore, bazuar në dispozitat ligjore për të cilat është rënë dakord nga të dyja Palët;

duke marrë parasysh rekomandimin mbi asistencën e ndërsjellë administrative dhe deklaratën për përmirësimin e bashkëpunimit doganor dhe asistencën e ndërsjellë administrative (Deklarata e Qipros), adoptuar respektivisht në dhjetor të vitit 1953 dhe korrik të vitit 2000, nga Këshilli i Bashkëpunimit Doganor, tashmë i njohur si Organizata Botërore e Doganave;

duke marrë parasysh konventat ndërkombëtare për ndalimin, kufizimin dhe masat specifike të kontrollit në lidhje me mallrat specifike;

duke marrë, gjithashtu, parasysh Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948,

ranë dakord për sa më poshtë vijon:

KAPITULLI I PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) "Administratë Doganore" do të nënkuptojë:

Për Republikën e Shqipërisë: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave.

Për Republikën e Bullgarisë: Agjencia Kombëtare e Doganore pranë Ministrisë së Financave.

b) "Legjislacion doganor" do të nënkuptojë çdo dispozitë ligjore ose administrative të zbatueshme nga secila administratë doganore në lidhje me importin, eksportin, transportimin, trazitin, depozitimin dhe lëvizjen e mallrave, përfshirë dispozitat ligjore dhe administrative që lidhen me masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit.

c) "Shkelje doganore" do të nënkuptojë çdo shkelje të mbetur në tentativë të legjislacionit doganor.

d) "Informacion" do të nënkuptojë çdo të dhënë, të përpunuar e analizuar ose jo, dhe dokumentet, raportet, si dhe komunikime të tjera në çdo lloj formati, përfshirë elektronik ose kopje të certifikuara ose të autentifikuara të tyre.

e) "Zyrtar" do të nënkuptojë çdo zyrtar doganor ose agjentë të tjerë qeveritarë, të caktuar nga secila administratë doganore.

f) "Person" do të nënkuptojë persona si legalë, ashtu edhe fizikë, me përjashtime të rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe.

g) "Të dhëna personale" do të nënkuptojë çdo të dhënë të një personi fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm.

h) "Administrata e kërkuar" do të nënkuptojë administratën doganore prej së cilës kërkohet asistencë.

j) "Administrata kërkuuese" do të nënkuptojë administratën doganore, e cila kërkon asistencë".

k) "Pala Kontraktuese e kërkuar" do të nënkuptojë Palën Kontraktuese, administratës doganore të së cilës i kërkohet të japë asistencë.

l) "Pala Kontraktuese kërkuuese" do të nënkuptojë Palën Kontraktuese, administrata doganore e së cilës kërkon asistencë.

KAPITULLI II FUSHËMBULIMI I MARRËVESHJES

Neni 2

1. Palët Kontraktuese do të sigurojnë për njëra-tjetrën, përmes administratave të tyre doganore, asistencë administrative sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, me qëllim zbatimin e saktë të legjislacionit doganor, si dhe për të parandaluar, hetuar dhe luftuar shkeljet doganore.

2. E gjithë asistenca sipas kësaj Marrëveshjeje do të sigurohet nga Palët Kontraktuese, në përputhje me dispozitat e tyre kombëtare ligjore dhe administrative, si dhe brenda kufijve të kompetencave dhe burimeve në dispozicion të administratave të tyre doganore.

3. Kjo Marrëveshje mbulon asistencën e ndërsjellë administrative midis Palëve Kontraktuese dhe nuk ka për qëllim të ndikojë në marrëveshjet ligjore të asistencës dypalëshe midis tyre. Në rast se asistenca dypalëshe do të sigurohet nga autoritete të tjera të Palëve Kontraktuese të kërkuara, administrata e kërkuar do të tregojë këto autoritete dhe, në rast se është në dijeni, marrëveshjet dhe rregullimet përkatëse të zbatueshme.

4. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk i japin të drejtë asnjë personi të pengojë ekzekutimin e një kërkesë.

KAPITULLI III FUSHA E ZBATIMIT TË ASISTENCËS

Neni 3

Informacion për zbatimin e legjislacionit doganor

1. Administratat doganore do t'i japin njëra-tjetrës, sipas kërkesës ose me iniciativë, informacion i cili do të ndihmojë për të siguruar zbatimin e saktë të legjislacionit doganor, si dhe në parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore. Ky informacion mund të përfshijë:

a) teknika të reja të zbatimit të legjislacionit doganor, të cilët kanë provuar efikasitetin e tyre;

b) tendenca, mënyra ose metoda të kryerjes së shkeljeve doganore;

c) mallra që njihen si objekt i shkeljeve doganore, si dhe metodat e transportit dhe depozitimit që përdoren në lidhje me këto mallra.

2. Asistenca e siguruar sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas kërkesës, do të përfshijë dhënien e informacionit për të siguruar përcaktimin e saktë të vlerës doganore.

3. Secila administratë doganore, në kryerjen e hetimeve në territorin përkatës kombëtar për administratën tjetër doganore, do të përdorë të gjitha mjetet në dispozicion për të siguruar asistencën e kërkuar.

KAPITULLI IV TIPE TË VEÇANTA ASISTENCE

Neni 4

Informacion lidhur me shkeljet doganore

1. Administratat doganore do t'i sigurojnë njëra-tjetrës, sipas kërkesës ose me iniciativë, informacion mbi aktivitetet e planifikuara në vazhdimësi ose të përfunduara, të cilat përbëjnë ose mund të përbëjnë një shkelje doganore.

2. Në rastet kur ekonomia, shëndeti publik, siguria publike ose çdo interes tjetër jetësor i njëjës Palë Kontraktuese mund të ketë një dëm të konsiderueshëm, administrata doganore e Palës tjetër Kontraktuese do ta japë pa vonesë atë informacion me iniciativën e saj, atëherë kur është e mundur.

Neni 5

Tipe të veçanta informacioni

1. Administrata e kërkuar do të sigurojë, sipas kërkesës, për administratën kërkuese informacion që lidhet me:

a) faktin nëse mallrat e importuara në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese janë eksportuar në mënyrë të ligjshme nga territori i Palës Kontraktuese të kërkuar;

b) faktin nëse mallrat e eksportuara nga territori i Palës Kontraktuese kërkuese janë importuar në mënyrë të ligjshme në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar dhe regjimin doganor, nëse ka, nën të cilin janë vendosur mallrat.

2. Administrata e kërkuar do të sigurojë, sipas kërkesës, për administratën kërkuese informacion lidhur me rastet kur kjo e fundit ka arsye për të dyshuar në informacionin e dhënë nga personi i interesuar në çështjet doganore.

Neni 6

Njoftimi

Administrata e kërkuar do të njoftojë, sipas kërkesës, një person, resident ose të vendosur në territorin e Palës Kontraktuese së kërkuar, për çdo vendim zyrtar të administratës kërkuese që ka të bëjë me atë person, në zbatim të legjislacionit doganor.

Neni 7

Mbikëqyrja dhe informacioni

Administrata e kërkuar sipas kërkesës, do të mbajë nën mbikëqyrje dhe do të informojë për:

a) mallra të transportuara ose magazinuara, të cilat dihet se janë përdorur ose ka dyshim se janë përdorur për shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese;

b) mjete transporti, të cilat dihet se janë përdorur ose ka dyshim se janë përdorur për të kryer shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese;

c) ambiente, të cilat dihet se janë përdorur ose ka dyshim se janë përdorur për të kryer shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese;

d) persona, për të cilët ka dijeni ose ekziston dyshimi të kenë kryer shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, veçanërisht për ata persona që hyjnë e dalin në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar.

Neni 8

Shpërndarja e kontrolluar

Palët Kontraktuese mund të lejojnë, me një marrëveshje dypalëshe, lëvizjen e mallrave të jashtëligjshme ose të dyshimta jashtë, përmes ose brenda territorit të tyre, me dijeninë ose nën kontrollin e autoriteteve kompetente, me qëllim hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore. Në rast se dhënia e një lejeje të tillë nuk është kompetencë e administratës doganore, kjo administratë do të përpiqet të bashkëpunojë me autoritetet kombëtare, të cilat e gëzojnë këtë kompetencë ose do t'ia kalojnë këtë rast këtyre autoriteteve.

Neni 9

Dispozitat e nenit 7 dhe nenit 8 do të zbatohen gjithashtu për drogat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët, të përcaktuar respektivisht në Konventën e vetme për drogat narkotike (1961), Konventën për substancat psikotropike (1971) dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotropike (1988).

KAPITULLI V INFORMACIONI

Neni 10

1. Informacioni original do të kërkohet vetëm në rastet kur kopjet do të jenë të pamjaftueshme dhe do të rikthehen në rastin më të parë. Të drejtat e administratës së kërkuar ose të palëve të treta që kanë lidhje me këtë do të mbeten të paprekura.

2. Çdo informacion që do të shkëmbehet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të shoqërohet nga të gjitha informacionet përkatëse për interpretimin dhe përdorimin e tyre.

KAPITULLI VI EKSPERTËT DHE DËSHMITARËT

Neni 11

Administrata e kërkuar mund të autorizojë, sipas kërkesës, zyrtarët e saj të paraqiten përpara një gjykate në territorin e Palës tjetër Kontraktuese si ekspertë ose dëshmitarë për çështjet e shkeljeve doganore.

KAPITULLI VII KOMUNIKIMI I KËRKESAVE

Neni 12

1. Kërkesat për asistencë, sipas kësaj Marrëveshjeje, do t'i adresohen drejtpërdrejt administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese. Kërkesat do të bëhen me shkrim ose elektronikisht dhe do të shoqërohen me çdo informacion që vlerësohet si i dobishëm dhe që përputhet me kërkesën. Administrata e kërkuar mund të kërkojë konfirmim me shkrim të kërkesave elektronike. Kur ta kërkojnë rrethanat, kërkesat mund të bëhen gojarisht. Një kërkesë e tillë do të konfirmohet me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Kërkesat e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni do të përfshijnë detajet e mëposhtme:

- a) emrin e administratës kërkuese;
- b) çështjen doganore për të cilën bëhet fjalë, tipin e asistencës së kërkuar dhe arsyen për kërkesën;
- c) një përshkrim të shkurtër të rastit që po rishikohet dhe elementet e tij ligjore dhe administrative;
- d) emrat dhe adresat e personave me të cilët lidhet kërkesa, në rast se dihen.

3. Kur administrata kërkuese kërkon të ndiqet një procedurë ose metodologji e caktuar, administrata e kërkuar do të bjerë dakord me këtë kërkesë, kushtëzuar nga dispozitat e saj kombëtare, ligjore dhe administrative.

4. Informacioni të cilit i referohet kjo Marrëveshjeje do t'i komunikohet zyrtarëve që janë përcaktuar, veçanërisht, për këtë qëllim nga secila administratë doganore. Një listë e këtyre zyrtarëve do t'i jepet administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI VIII EKZEKUTIMI I KËRKESAVE

Neni 13

Mënyrat e marrjes së informacionit

1. Në rast se administrata e kërkuar nuk e disponon informacionin e kërkuar, atëherë do të nisë kërkimet për të marrë atë informacion.

2. Në rast se administrata e kërkuar nuk është autoriteti i duhur për të nisur kërkimet për të marrë informacionin e kërkuar, ajo mund, përveçse të tregojë autoritetin e duhur, t'i transmetojë kërkesën autoritetit të duhur.

Neni 14

Prezenca e zyrtarëve në territorin e Palës tjetër Kontraktuese

1. Me anë të një kërkesë me shkrim, me qëllim hetimin e një shkeljeje doganore zyrtare, specifikisht të përcaktuar nga administrata kërkuese, me autorizim të administratës së kërkuar dhe në përputhje me kushtet që kjo e fundit mund të vendosë, mund:

a) të ekzaminojnë, në zyrat e administratës së kërkuar, dokumente, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me shkeljen doganore, si dhe të pajisen me kopjet përkatëse;

b) të jenë të pranishëm gjatë një hetimi të kryer nga administrata e kërkuar në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar dhe që ka lidhje me administratën kërkuese.

Neni 15

Prezenca e zyrtarëve të administratës kërkuese me ftesë të administratës së kërkuar

Kur administrata e kërkuar e konsideron të dobishme ose të nevojshme që një zyrtar i administratës kërkuese të jetë prezent, në vijim të një kërkesë, gjatë marrjes së masave të asistencës, ajo do të njoftojë administratën kërkuese.

Neni 16

Dispozita për vizitat e zyrtarëve

1. Kur zyrtarët e njëres Palë Kontraktuese janë prezent në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, ata duhet të kenë në gjendje që në çdo kohë të japin prova të rolit të tyre zyrtar.

2. Zyrtarët e caktuar nga administrata kërkuese, për të qenë prezent në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar, siç parashikohet në nenet 14 dhe 15, do të kenë tërësisht një rol këshillues.

3. Ndërkohë që janë aty, ata do të gëzojnë mbrojtjen që iu është dhënë zyrtarëve doganorë të Palës tjetër Kontraktuese për atë sa e lejojnë ligjet në fuqi, si dhe do të jenë përgjegjës për çdo shkelje që mund të kryejnë.

KAPITULLI IX KONFIDENCIALITETI I INFORMACIONIT

Neni 17

1. Çdo informacion i marrë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të përdoret vetëm nga administratat doganore dhe vetëm për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur administrata doganore që jep informacionin autorizon përdorimin e tij nga autoritete të tjera ose për qëllime të tjera.

2. Çdo informacion i marrë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të trajtohet si konfidencial dhe do të jetë objekt të paktën i të njëjtës mbrojtje dhe konfidencialiteti, siç është i njëjti tip informacioni, objekt i ligjit kombëtar të Palës Kontraktuese që merr informacionin.

KAPITULLI X MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 18

Shkëmbimi i të dhënave personale në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje nuk do të fillojë derisa Palët Kontraktuese të kenë rënë dakord, në përputhje me nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje, që këto të dhëna do të kenë një nivel mbrojtjeje, i cili do të përmbushë kërkesat në ligjin kombëtar të Palës Kontraktuese që jep të dhënat.

Sipas kontekstit të këtij neni, Palët Kontraktuese do t'i sigurojnë njëra-tjetrës legjislacionet përkatëse në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

KAPITULLI XI PËRJASHTIMET

Neni 19

Në rastet kur asistenca e dhënë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje mund të cenojë sovranitetin, sigurinë, politikën publike ose çdo interes tjetër thelbësor kombëtar të njëres Palë Kontraktuese, ose të paragjykojë ndonjë interes të ligjshëm tregtar ose profesional, asistenca mund të refuzohet ose mund të jepet duke përmbushur termat dhe kushtet që administrata e kërkuar mund të kërkojë.

Në rast se administrata kërkuese nuk do të jetë në gjendje të përmbushë një kërkesë të ngjashme të bërë nga administrata e kërkuar, atëherë ajo do të theksojë një gjë të tillë në kërkesën e saj. Përmbushja e një kërkesë të tillë do të bëhet me pëlqimin e administratës së kërkuar.

Asistenca mund të shtyhet nëse ekzistojnë prova për të besuar se ajo do të ndikojë në një hetim, ndjekje penale apo procedim që është duke u kryer. Në këtë rast, administrata e kërkuar do të konsultohet me administratën kërkuese për të përcaktuar nëse asistenca mund të jepet në bazë të kushteve dhe termave që administrata e kërkuar mund të vendosë.

Në rastet kur asistenca do të refuzohet ose vonohet, atëherë duhet të jepen motivet për këtë refuzim ose vonesë.

KAPITULLI XII SHPENZIMET

Neni 20

1. Bazuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, administratat doganore do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet për rimbursime të shpenzimeve, si pasojë e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shpenzimet dhe dietat që do t'i paguhën ekspertëve dhe specialistëve, si dhe të gjitha shpenzimet e përkthyesve dhe interpretëve, me përjashtim të punonjësve qeveritarë, do të përballohen nga administrata kërkuese.

3. Në rast se janë ose kërkohen shpenzime të një natyre të konsiderueshme ose të jashtëzakonshme për të ekzekutuar një kërkesë, Palët Kontraktuese do të konsultohen për të përcaktuar kushtet dhe termat në bazë të të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe për mënyrën sipas së cilës do të përballohen shpenzimet.

KAPITULLI XIII
ZBATIMI I MARRËVESHJES

Neni 21

Administrata doganore do të vendosë bashkërisht për detajet, të cilat do të lehtësojnë vënien në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI XIV
ZBATIMI TERRITORIAL

Neni 22

Kjo Marrëveshje do të jetë e zbatueshme në territoret e të dy Palëve Kontraktuese, siç është përcaktuar në dispozitat e tyre kombëtare ligjore dhe administrative.

KAPITULLI XV
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 23

1. Administratat doganore do të përpiqen të zgjidhin, duke rënë dakord midis tyre, mosmarrëveshjet ose vështirësi të tjera që kanë të bëjnë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Mosmarrëveshjet ose vështirësitë që nuk do të mund të zgjidhen, do të zgjidhen me mjete diplomatike.

KAPITULLI XVI
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 24

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pasi Palët Kontraktuese të kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim nëpërmjet rrugëve diplomatike që kërkesat kushtetuese dhe të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

Neni 25

Kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje të pakufizuar, por secila Palë Kontraktuese mund ta përfundojë në çdo kohë, duke njoftuar nëpërmjet mjeteve diplomatike.

2. Përfundimi do të ketë efekt tre muaj më vonë nga data e njoftimit të Palës tjetër Kontraktuese. Megjithatë, procedimet që janë duke u kryer gjatë kohës së përfundimit do të kryhen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 26

Rishikimi

Palët Kontraktuese do të takohen për të rishikuar këtë Marrëveshje sipas kërkesës ose në fund të pesë vjetëve nga data e hyrjes në fuqi, me përjashtim të rasteve kur ato njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim që një rishikim i tillë nuk është i nevojshëm.

Dëshmitarë për sa më sipër, nënshkruarit, të autorizuar përkatësisht, nënshkruan këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Tiranë, në datë 17.9.2003 në dy kopje në gjuhët shqip, bullgarisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njësoj autentike. Në rast të divergjencave në interpretimin midis teksteve shqip dhe bullgarisht, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

UDHËZIM
Nr. 3, datë 10.7.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 1.1.1996 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PROKURIMIN PUBLIK", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pika 3 kapitulli I "Enti prokurues dhe urdhri i prokurimit" ndryshon si më poshtë vijon:

"3. Përcaktimi i fondit limit argumentohet nga enti prokurues dhe bëhet në bazë të çmimeve të publikuara nga INSTAT-i dhe institucionet e tjera shtetërore përkatëse. Për çmimet e papublikuara, përcaktimi i fondit limit të bëhet në mbështetje të përvojës së mëparshme të entit prokurues ose sipas testimi të tregut."

- Në kapitullin II "Procedurat e prokurimit" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

"1. Procedura e prokurimit përcaktohet në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik" dhe të vendimeve të Këshillit të Ministrave."

- Në shkronjën "a", "Procedurat e tenderave të hapur dhe ndërkombëtarë" pika 2 bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e parë dhe të dytë të kësaj pike fjala "...kombësia..." zëvendësohet me "...shtetësia..."

Paragrafi i katërt ndryshon si më poshtë vijon:

"Kjo procedurë të përdoret gjithnjë, kur me anë të saj mund të arrihet një konkurrencë e efektshme, sipas kufijve monetarë të përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave. Në rast të kundërt, të kalohet në procedura ndërkombëtare, sipas nenit 41 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik."

- Në shkronjën "b" "Procedurat e parakualifikimit" pika 2, bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i tretë ndryshon si më poshtë vijon:

"Kjo procedurë, gjithashtu, i jep mundësinë entit prokurues t'u dërgojë ftesa për paraqitjen e ofertave tekniko-ekonomike vetëm shoqërive të parakualifikuara, të cilat kanë aftësitë dhe burimet e mjaftueshme për të konkurruar, duke kufizuar numrin e shoqërive që do të paraqesin oferta (pas parakualifikimit)."

Paragrafi i pestë ndryshon si më poshtë vijon:

"Në dokumentet e parakualifikimit kërkohet që pjesëmarrësit të plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 12/1 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik."

Pas paragrafit të gjashtë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Për paraqitjen e ofertës tekniko-ekonomike, sipas gjykimit të entit prokurues dhe në varësi të objektit të prokurimit, afati të jetë 10 deri në 20 ditë."

- Në shkronjën "c" "Tenderi me dy faza", pika 2 të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në paragrafin e dytë pas fjalës "...kjo..." shtohet fjala "...procedurë..."

Paragrafi i fundit ndryshon si më poshtë vijon:

"Faza e parë e tenderit me dy faza mund të bëhet e hapur ose e kufizuar, në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik" dhe të vendimeve të Këshillit të Ministrave, duke respektuar kufijtë monetarë dhe afatet kohore të përcaktuara në vendim. Faza e dytë e tenderit me dy faza të respektojë kufijtë kohorë të tenderit të kufizuar".

- Në shkronjën "d" "Kërkesës për kuotim", pika 2 bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i tretë shfuqizohet.

Në paragrafin e fundit shprehja "...më shumë se dy..." zëvendësohet me shprehjen "...jo më pak se tre...".

- Në kapitullin III "Dokumentet e tenderit" bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e parë shprehja "...sigurimin e kontratës..." zëvendësohet me "...formularin e sigurimit të kontratës..." dhe pas shprehjes "...njoftimin e fituesit..." shtohen shprehjet "...formulari i kontratës..." dhe "...formulari i autorizimit të prodhuesit..."

Pika 1 e paragrafit të dytë "Për prokurimin e ndërtimeve" ndryshon si më poshtë vijon:

"1. - projektet e zbatimit dhe specifikimet teknike;

- preventivi;

- grafiku për kryerjen e ndërtimeve."

Në pikën 2 të paragrafit të tretë "Për prokurimin e mallrave" shprehja "...kriteret e vlerësimit..." shfuqizohet.

Pika 3 e paragrafit të katërt "Për prokurimin e shërbimeve të projektimit" ndryshon si më poshtë vijon:

"3. - termat e referencës;

- grafiku i zbatimit;

- kërkesat për personelin kryesor;

- skedari i tarifave, kostove dhe shpenzimeve, nëse kërkohet..."

Në paragrafin e parë "Ftesa për oferta" të shkronjës "a" "Pjesa e përgjithshme" fjala "...çmimin..." zëvendësohet me "...vleftën..."

Në paragrafin e dytë tek "Udhëzimet për pjesëmarrësit në tender" të shkronjës "a" "Pjesa e përgjithshme", në fund të fjalisë së parë, pas fjalës "...ndryshime..." shtohen fjalët "...në to..."

Në paragrafin e pestë tek "Udhëzimet për pjesëmarrësit në tender" të shkronjës "a" "Pjesa e përgjithshme", në fjalinë e dytë përpara shprehjes "...28 ditëve..." shtohet emërtimi "...Bankës së Shqipërisë..."

Pjesa "Formulari i sigurimit të ofertës" e shkronjës "a" "Pjesa e përgjithshme" ndryshon si më poshtë vijon:

"Formulari i sigurimit të ofertës shërben për të mbrojtur entin prokurues nga ofertat e papërgjegjshme. Formulari i sigurimit të ofertës të ketë formën e një depozite a garancie, të lëshuar nga një bankë ose nga shoqëritë e licencuara nga shteti për këtë qëllim. Sigurimi i ofertës u çngurtësohet menjëherë ofertuesve të pasuksesshëm, ndërsa kandidatëve të tjerë u kthehet pas lidhjes së kontratës."

Në paragrafin e parë të pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë", fjala "...sipërmarrjet..." zëvendësohet me "...prokurimin..."

Në paragrafin e dytë dhe të tretë të pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë", fjala "...sipërmarrjet..." zëvendësohet me "...ndërtimet..."

Pika 3 e paragrafit të pestë të pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" ndryshon si më poshtë vijon:

"3. Kontratat dhe aktet e tyre të kolaudimit përfundimtar, për objekte të ngjashme, të realizuara gjatë veprimtarisë së shoqërisë në tre vitet e fundit, ku të paktën vlera e një objekti të jetë më e vogël se 50 për qind e vlerës së objektit që prokurohet."

Paragrafi i gjashtë, i pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë", ndryshon si më poshtë vijon:

"Nëse sipërmarrësi plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, vlerësohet për çmimin (dhe afatin, nëse është parashikuar si kriter vlerësimi në dokumentet e tenderit), që paraqet në ofertën ekonomike, ku si çmim do të

merret vlera e plotë e preventivit. "

Paragrafët e nëntë dhe të dhjetë të pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" zëvendësohen me fjalinë "Kriter vlerësues do të jetë çmimi më i ulët. "

Paragrafi i gjashtë i pikës 2 "Për mallrat" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" ndryshon si më poshtë vijon:

"Në rastet kur kriteret e vlerësimit janë më shumë se një dhe në varësi të objektit të prokurimit, kriteret tjerë që mund të merren parasysh janë: shpenzimet për transportin e brendshëm dhe sigurimin deri në vendin e dorëzimit, grafiku i pagesave, koha e livrimit, shpenzimet operative, efektiviteti dhe përshtatshmëria e pajisjeve, si dhe gatishmëria e shërbimeve dhe e pjesëve të këmbimit etj. Për të gjithë këta faktorë, veç çmimit, që do të përdoret për të përcaktuar ofertën më të leverdisshme, enti prokurues duhet të përcaktojë metodologjinë e vlerësimit për secilin kriter të shprehur në vlerë monetare. "

Paragrafi i tretë i pikës 3 "Për shërbimet" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" ndryshon si më poshtë vijon:

"Në rastet kur kriteret e vlerësimit janë më shumë se një dhe në varësi të objektit të prokurimit, kriteret tjerë që mund të merren parasysh janë: përvoja e mëparshme, personeli që do të kryejë këtë shërbim etj. Për të gjithë këta faktorë, veç çmimit, që do të përdoret për të përcaktuar ofertën më të leverdisshme, enti prokurues duhet të përcaktojë metodologjinë e vlerësimit për secilin kriter të shprehur në vlerë monetare. "

Në pikën 3 "Për shërbimet" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" paragrafët i tretë dhe i katërt shfuqizohen.

- Në kapitullin IV "Komisioni i vlerësimit të ofertave dhe njësia e prokurimit (Hartuesit e dokumenteve të tenderit)" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në paragrafin e pestë pas fjalës "...prokurimeve..." shtohet shprehja "...të mësipërme..."

Paragrafi i trembëdhjetë ndryshon si më poshtë vijon:

"Për tenderat kombëtarë afati i dorëzimit të ofertave të jetë afati i përcaktuar në dokumentet e tenderit. "

Në paragrafin e katërbëdhjetë fjala "...ose..." zëvendësohet me "...dhe..."

Paragrafi i gjashtëmbëdhjetë ndryshon si më poshtë vijon:

"Ofertat e paraqitura nga kandidatët merren në dorëzim nga komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili bën pranimin e tyre, dhe në prani të ofertuesve hidhen në një kuti të veçantë, që vendoset në një vend të dukshëm. Më pas komisioni i vlerësimit të ofertave të procedojë me hapjen e ofertave. "

Paragrafët i shtatëmbëdhjetë, i tetëmbëdhjetë, i nëntëmbëdhjetë dhe i njëzet zëvendësohen me paragrafët me këtë përmbajtje:

"Pas hapjes së ofertave të paraqitura nga ofertuesit, njëri nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave lexon me zë të lartë emrin e ofertuesit, dokumentacionin administrativo-ligjor kualifikues dhe vleftën totale të çdo oferte, si dhe i regjistron në procesverbal, i cili hartohet në mbështetje të nenit 31/3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 " Për prokurimin publik".

Enti prokurues të shqyrtojë të gjitha dokumentet e paraqitura në çdo ofertë për të konfirmuar nëse ato janë në përputhje të plotë me dokumentet e tenderit dhe për të përcaktuar plotshmërinë e çdo dokumenti të paraqitur. Nëse njëri prej dokumenteve të kërkuar mungon ose është i paplotë oferta refuzohet.

Enti prokurues të shqyrtojë çdo ofertë për të konfirmuar se ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe se i përmbush të gjitha afatet dhe kushtet. Oferta, që është në përputhje me të gjitha kërkesat duke përfshirë afatet dhe kushtet, konsiderohet e vlefshme.

Enti prokurues të vlerësojë dhe krahasojë ofertat e kualifikuara si të vlefshme, me qëllim që të përcaktojë ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e paraqitura në dokumentet e tenderit. Asnjë kriter tjetër nuk do të përdoret nëse nuk parashikohet në dokumentet e tenderit. "

Paragrafi i njëzet e dytë shfuqizohet.

Në paragrafin e njëzetepesë fjala "...kandidati..." zëvendësohet me shprehjen "...ofertuesi fitues..."

Në paragrafin e njëzetetë shprehja "...rregullave të prokurimit publik, të përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave..." zëvendësohet me shprehjen "...mënyrës dhe kohës që parashikohet në ligjin për arkivat dhe ligjin për informimin publik.".

Paragrafi i tridhjetë ndryshon si më poshtë vijon:

"Komisioni i vlerësimit të ofertave bën klasifikimin përfundimtar të ofertave, i cili nënshkruhet nga kryetari i komisionit, dhe ua njofton atë zyrtarisht ofertuesve.".

- Në kapitullin V "Ankimi administrativ" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në paragrafin e tretë shprehja "...10 ditësh..." zëvendësohet me "...5 ditësh...".

Në fund të kapitullit shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Ofertuesi që nuk është dakord me përgjigjen e entit prokurues ka të drejtë të ankohet sipas pikës 3 të nenit 44 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik.".

- Në kapitullin VI "Miratimi" bëhet ky ndryshim:

Paragrafi i gjashtë shfuqizohet.

- Në kapitullin VII "Të përgjithshme" bëhen këto ndryshime:

Paragrafi "Procedurat që ndiqen në rast të mosigurimit të konkurrencës" ndryshon si më poshtë vijon:

"Procedurat e prokurimit të përsëriten për procedurën "Tender i hapur" kur:

- paraqitet vetëm një ofertë;

- pas shqyrtimit të ofertave, mbetet vetëm një ofertë e vlefshme.

Procedurat e prokurimit të përsëriten për procedurën "Tender i kufizur" dhe "Kërkesë për kuotim" kur:

- paraqiten jo më pak se tri oferta;

- ofertat nuk i plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet tekniko-ekonomike dhe në garë mbeten më pak se tre ofertues.".

Paragrafi i fundit zëvendësohet me paragrafin me këtë përmbajtje:

"Dokumentet standarde të tenderit për mallrat, ndërtimet dhe shërbimet dhe manuali i përdoruesit miratohen bashkë me këtë udhëzim. Dokumentet standarde të tenderit, që i bashkëlidhen udhëzimit nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave "Për prokurimin publik", i ndryshuar, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.31, datë 19.11.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Pllaçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 23.10.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çëshjen me nr.35 Akti, që u përket:

KËRKUES: 53 mijë zgjedhës, me nismëtarë Gëzim Kalaja, Bujar Cani, Tomorr Shahini, Gani Lami, Agim Lamja, Hiqmet Mella, Sami Karriqi, Bashkim Hoxha, Osman Redhi, Dëfrim Spahiu, Ismail Lila, Bilbil Kashi, përfaqësuar nga avokat Dervish Dumi, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga z.Spiro Peçi, Ministër i Drejtësisë.
3. MINISTRIA E FINANCAVE, përfaqësuar nga z.Mimoza Dhëmbi e Genc Çifliku, me autorizim.
4. MINISTRIA E PUNËS DHE E ÇËSHTJEVE SOCIALE, përfaqësuar znj.Albana Shtylla, me autorizim dhe avokat Arben Hakani, me prokurë.

OBJEKTI: Kushtetutshmëria e kërkesës për zhvillimin e referendumit për shfuqizimin e neneve 4 e 6 të ligjit nr.8889, datë 25.4.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në bazë të nenit 152, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 129, paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Pllaçi, përfaqësuesin e palës kërkuese, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002 janë bërë disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht, ndërmjet të tjerash, me nenet 4 dhe 6 të ligjit të viti 2002 është rritur moshja për përfitimin e pensionit të pleqërisë, për burrat nga 60 në 65 vjeç dhe për gratë nga 55 në 60 vjeç, duke ndryshuar nenin 31 të ligjit të vitit 1993, që përcakton kushtet e përfitimit të këtij pensioni, si dhe nenin 34 të po këtij ligji, që përcakton kushtet e përfitimit të pensionit të pjesshëm të pleqërisë.

Kërkuesit, në bazë të nenit 126 pika 2 të Kodit Zgjedhor, i kanë paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një kërkesë për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm me objekt shfuqizimin e neneve 4 e 6 të ligjit të mësipërm.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi ka verifikuar rregullsinë e kërkesës, në bazë të nenit 129 pika 1 të Kodit Zgjedhor, i ka përcjellë kërkesën për referendum të përgjithshëm Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar paraprakisht kushtetutshmërinë e saj.

Lidhur me kushtetutshmërinë e kërkesës për referendum, gjatë gjykimit kanë shfaqur opinionet e tyre pala kërkuese dhe subjektet e interesuara. Këto opinione janë shfaqur në aspektin e pranueshmërisë së kërkesës në vështrim të nenit 126 pika 3 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit “Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligjit pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme”, si dhe në aspektin e kushtetutshmërisë së saj, në vështrim të nenit 151 pika 2 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet se “Çështjet që lidhen me ... buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit ... nuk mund të shtrohen në asnjë referendum”.

Sipas opinionit të kërkuesve, kërkesa e paraqitur prej tyre është në pajtim me nenin 126, pika 3 të Kodit Zgjedhor, sepse në rast shfuqizimi të dispozitave-objekt referendumi-pjesa e mbetur e ligjit është e vetëmjaftueshme, mbasi në këtë rast hyjnë në fuqi dispozitat e shfuqizuara të ligjit të vitit 1993. Për sa i përket aspektit të dytë, pala kërkuese shprehu opinionin se ligji që kundërshtohet nuk përfshihet në kategorinë e atyre ligjeve për të cilët Kushtetuta nuk lejon të shtrohen në referendum, pasi ky ligj nuk implikon Buxhetin e Shtetit.

Subjektet e interesuara, në dy aspektet e mësipërme, u shprehën se kërkesa për referendum është e papranueshme.

Lidhur me aspektin e parë, subjektet e interesuara parashtruan se kërkesa për referendum për shfuqizimin e dispozitave të kundërshtuara, është e papranueshme, sepse me shfuqizimin e këtyre dispozitave pjesa e mbetur e këtij ligji nuk është e vetëmjaftueshme. Ndërmjet të tjerash, ata

argumentuan se pjesa e ligjit që mbetet nuk do të funksionojë sipas qëllimit që ka patur ky ligj - përmirësimin e balancës së skemës së sigurimeve shoqërore. Kështu, sipas tyre, në kushtet e kontributeve të ulura me ligjin e kundërshtuar dhe të moshës për përfitimin e pensionit, të përcaktuar me ligjin e vitit 1993, skema e sigurimeve shoqërore nuk do të funksionojë, sepse nuk do të përballojë detyrimet për pagesat e pensioneve me fondet e mbledhura nga kontribuesit e përfshirë në këtë skemë.

Për sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum, subjektet e interesuara shprehën opinionin se ligji i kundërshtuar i vitit 2002, përfshihet në atë kategori ligjesh, të cilët, në vështrimin kushtetues, nuk mund të shtrohen në referendum. Në këtë drejtim, subjektet e interesuara, në mënyrë të përmbledhur, argumentojnë se ndryshimet në legjisllacionin e sigurimeve shoqërore kanë ndikim mbi Buxhetin e Shtetit. Sipas tyre, shteti paraqitet si kontribues në fondin e sigurimeve shoqërore, ndërmjet të tjerëve, në rastin e parashikuar nga neni 66 shkronja "a" (me cilësinë e punëdhënësit) dhe në rastet e parashikuara nga shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të po këtij neni. Përveç kësaj, Buxheti i Shtetit mbulon diferencën e krijuar, në rastin kur shpenzimet për sigurimet shoqërore nuk mbuloohen me të ardhurat e fondit të mësipërm (neni 67), si dhe garanton fondin e sigurimeve shoqërore në rast falimentimi (neni 69 i po këtij ligji).

1. Në rrethanat e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se shqyrtimi i kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum dikton nevojën e sqarimit të kushteve të përgjithshme që lidhen me institutin e referendumit në përgjithësi dhe atij shfuqizues në veçanti, në vështrim të nenit 151 të Kushtetutës.

Në një vështrim të përgjithshëm, pozicioni i referendumit si mjet kushtetues është i lidhur me nocionin e sovranitetit të popullit (neni 2/1 i Kushtetutës), që ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (neni 2/2). Në këtë drejtim, një rëndësi themelore merr çështja e përcaktimit të kushteve dhe rasteve në të cilat populli mund t'a ushtrojë sovranitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Sipas doktrinës, parimi i ushtrimit të sovranitetit nga populli nënkupton një koncept demokratik sipas kriterëve të një demokracie përfaqësuese, që përmban edhe elementë që mundësojnë ushtrimin direkt të demokracisë kushtetuese. Me këtë kuptohet që populli, të drejtën për të ushtruar funksion ligjvënës, normalisht, nuk e ushtron vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij. Demokracia përfaqësuese, historikisht, është konceptuar si formë e zakonshme e qeverisjes. Ajo është shprehje e demokracisë që mundëson shfaqjen e vullnetit të shumicës në formën e një akti që do t'i shërbejë interesit të përgjithshëm.

Instrumentet e demokracisë direkte zënë vend në këtë vështrim, jo si pushtet konkurrenës i organeve përfaqësuese, por si instrumente që mundësojnë mënjanimin e mungesës së veprimit nga ana e përfaqësuesve ose balancimin e kësaj mungese. Dispozitat e Kushtetutës lejojnë ushtrimin e sovranitetit të popullit nëpërmjet referendumeve, përderisa kjo nuk bie në kundërshtim me sistemin e procesit ligjvënës.

Pra edhe referendumi, si një nga instrumentet e demokracisë direkte, nuk përbën alternativë ndaj procesit ligjvënës të parlamentit. Ai nuk mundëson bërjen e ligjeve, funksion i cili u është ngarkuar ekskluzivisht ligjvënësve. Në këtë mënyrë, referendumi paraqitet si mjet për integrimin dhe stimulimin e procesit ligjvënës në parlament, në rastet kur nuk gjen zbatim parimi i përputhjes së vullnetit të shumicës parlamentare me shumicën e popullit në një çështje konkrete. Pra, bëhet fjalë për një instrument që mundëson transmetimin e mendimit të zgjedhësve në drejtim të instancave politike.

Gjykata Kushtetuese konstaton se të drejtën e nismës për referendum të përgjithshëm, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, populli e gëzon vetëm për shfuqizimin e një ligji (referendumi shfuqizues), si dhe për çështje të një rëndësie të veçantë (neni 150/1 i Kushtetutës), ndërsa llojet e tjera të referendumit të përgjithshëm, siç janë: referendumi për miratimin e një projektligji të një rëndësie të veçantë, si dhe ai për miratimin e projektamendamenteve kushtetuese

mund të mbahen vetëm me miratimin e Kuvendit të Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese vlerëson se hartuesit e Kushtetutës, me këtë rregullim, kanë dashur qëllimisht ta parashikonin referendumin në mënyrë të kufizuar, gjë që është në harmoni me parimin themelor të demokracisë parlamentare (neni 1 i Kushtetutës). Në të kundërtën, do të krijohej një model konkurrues në procesin legjislativ parlamentar, që nuk përputhet me këtë parim themelor kushtetues.

Përveç sa më sipër, me qëllim që instituti i referendumit shfuqizues t'i shërbejë qëllimit për të cilin është pranuar, Kushtetuta ka parashikuar disa kritere, si: numri i domosdoshëm i firmave për të ndërmarrë nismën referendare (50 mijë shtetas me të drejtë vote),¹ përjashtimi nga referendumi i një kategorie të caktuar çështjesh². Disa kritere që lidhen me pranueshmërinë e kërkesës për referendum janë parashikuar edhe në Kodin Zgjedhor. Përveç këtyre, lidhur me këtë institut, jurisprudenca ka identifikuar edhe disa kufizime të tjera të nënkuptuara, të cilat rezultojnë nga fryma e sistemit Kushtetues³.

Çështja që i është paraqitur për shqyrtim kësaj Gjykate ka të bëjë me kërkesën për zhvillimin e një referendumi për shfuqizim ligji dhe konkretisht të ligjit nr.8889, datë 25.4.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 4 e 6, me të cilët është rritur moshja e daljes në pension pleqërie për burrat nga 60 në 65 vjeç dhe për gratë nga 55 në 60 vjeç.

Gjykata Kushtetuese, në bazë nenit 152 të Kushtetutës, duhet të shqyrtojë kushtetutshmërinë e kësaj kërkesë në linjat që u parashtruan më sipër.

2. Lidhur me kushtetutshmërinë e referendumit, Gjykata duhet të verifikojë nëse, në rastin në shqyrtim, janë të pranishëm ndalime të atij lloji që parashikon neni 151 paragrafi 2 i Kushtetutës, gjë që bën të nevojshme interpretimin e kësaj dispozite. Më konkretisht, Gjykata duhet të verifikojë nëse ligji i kërkuar për t'u hedhur në referendum me qëllim shfuqizimi është nga ajo kategori ligjesh, për të cilat Kushtetuta nuk lejon ndërmarrjen e një procedure të tillë referendare.

Dispozita kushtetuese e mësipërme përmend “Çështjet që lidhen me ... buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, ...”, por nuk specifikon ligjet konkrete, që rregullojnë këto çështje. Gjykata Kushtetuese vlerëson se kuadri ligjor i financave publike, është kompleks dhe përfshin ligjet e buxhetit, të taksave e të detyrimeve financiare të shtetit. Këto ligje, për karakterin e fushave që mbulojnë dhe efektet që prodhojnë kanë një lidhje të ngushtë midis tyre. Përveç këtyre ligjeve, për të cilat parashikohet ndalim i shprehur kushtetues për t'u paraqitur në referendum, jurisprudenca ka identifikuar edhe ligje të tjera, të cilat, nisur nga natyra dhe efektet që prodhojnë, kanë një lidhje të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë me çështjet e buxhetit, të taksave dhe të detyrimeve financiare të shtetit, për shkak të pasojave të ngjashme me ato që prodhojnë këto të fundit (ndalime të nënkuptuara)⁴.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se këtij përjashtimi kushtetues i nënshtrohet edhe ligji për sigurimet shoqërore. Për natyrën e tij, sistemi i sigurimeve shoqërore është një sistem “i hapur”, gjë që nënkupton se ndryshimet në të janë jo vetëm të pranueshme, por edhe të pashmangshme. Për pasojë, iniciativa e ligjvënësit në këtë fushë mbetet veçanërisht e gjerë. Faktorët që i nxisin këto ndryshime mund të jenë çështje me interes publik, si: përpjekja për ta bërë sa më të drejtë sistemin për të dy palët, përfitues dhe kontribues, situata financiare e buxhetit, si dhe faktorë socialë. Pra, ndërhyrja në sistemin e sigurimeve shoqërore është kompetencë ekskluzive e ligjvënësit, por duke iu përmbajtur kufijve të Kushtetutës për respektimin e të drejtave themelore të shtetasve⁵.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa për referendum për shfuqizimin e rregullimeve të reja të sigurimeve shoqërore duhet të vlerësohet jokushtetuese.

Duke shqyrtuar dispozitat e ligjit të vitit 1993 “Për sigurimet shoqërore”, si dhe të ligjit “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit”, Gjykata Kushtetuese konkludon se ligji “Për sigurimet shoqërore” ka lidhje të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë me ligjin “Për Buxhetin e Shtetit”, sa

¹ Neni 150, pg 1 i Kushtetutës

² Neni 151, pg 2 i Kushtetutës dhe neni 126, pg 3 dhe 5 i Kodit Zgjedhor

³ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese italiane nr.16, viti 1978.

⁴ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr.2, viti 1994

⁵ Vendime të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, 11, 221, 22, 242, 26, 44 (61f)

që shfuqizimi i dispozitave të kundërshtuara do të prishte ekuilibret financiare të sistemit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore dhe do të prekte drejtpërdrejt Buxhetin e Shtetit.

Një lidhje e tillë e ngushtë e ligjit të kundërshtuar me ligjet e buxhetit rezulton po të shqyrtojmë kuadrin ligjor përkatës dhe konkretisht nenet 64, 66, 67 e 69 të ligjit “Për sigurimet shoqërore”.

Kështu, sipas nenit 64 të këtij ligji (i cili përcakton subjektet që kontribuojnë në fondin e sigurimeve shoqërore), kontribues në fondin e sigurimeve shoqërore, ndërmjet të tjerëve, është edhe punëdhënësi, i cili mund të jetë person privat ose shteti. Për pasojë, në rast se do të ulej mosha e pensionit, për të garantuar vazhdimësinë dhe funksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore, do të duhej të rritej masa e kontributit të punëdhënësve, gjë që, duke e lidhur drejtpërdrejt me pagën, do të sillte rritjen e shpenzimeve buxhetore. Po kështu, duke shqyrtuar nenin 66 të ligjit, i cili përcakton “burimet e të ardhurave të fondit të sigurimeve shoqërore”, rezulton se përveç kontributit të personave të siguruar dhe të punëdhënësve të tyre, si dhe disa të ardhurave të tjera, në këtë fond përfshihen edhe kontributet, subvencionet për të mbështetur shpenzimet shtesë, si dhe subvencione të buxhetit të miratuara nga Kuvendi. Për pasojë, në rast se do të ulej mosha e pensionit, kjo do të sillte uljen e masës së kontributeve, në kuptim të shkronjës “a” të nenit 66 të përmendur më sipër, gjë e cila do të kërkonte një rritje të kontributit nga Buxheti i Shtetit, në vështrim të shkronjave “b” e vijuese të po këtij neni. Përveç këtyre, lidhja e sigurimeve shoqërore me buxhetin e shtetit del në pah edhe në nenin 67 të ligjit. Kështu, sipas pikës 2 të këtij neni, “kur shpenzimet për sigurimet shoqërore nuk mbulohen me të ardhurat e parashikuara në nenin 66, diferenca mbulohet nga Buxheti i Shtetit”. Ndërsa, sipas nenit 69 të ligjit të sipërpërmendur, “shteti garanton fondin e sigurimeve shoqërore në rast falimentimi”.

3. Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet edhe për pranueshmërinë e kërkesës për referendum, në vështrim të kufizimit që imponon neni 126 pika 3 e Kodit Zgjedhor, sipas të cilit “Kërkesa për shfuqizimin e një pjese të ligjit pranohet vetëm kur pjesa tjetër e ligjit është e vetëmjaftueshme”.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky ndalim i parashikuar në Kodin Zgjedhor është në harmoni me parimin kushtetues të demokracisë përfaqësuese. Në këtë aspekt, në qoftë se pas shfuqizimit me referendum pjesa e mbetur e ligjit nuk do të ishte e vetëmjaftueshme, atëherë do të krijohej vakum ligjor, situatë kjo që e detyron ligjvënësin që, edhe kundër dëshirës së tij, të plotësojë këtë vakum. Kjo situatë, në qoftë se do të përsëritej shpesh, do të çenonte parimin themelor të demokracisë parlamentare. Nga ana tjetër, ashtu siç konstatohet edhe në jurisprudencë, “në qoftë se ligjvënësi nuk reagon në përgjigje të vakumit legjislativ, atëherë sistemi kushtetues nuk ofron ndonjë mjet efektiv dhe kjo situatë mund të çonte në një krizë në sistemin e demokracisë përfaqësuese.”⁶ Gjykata vlerëson, gjithashtu, se me ndalimin e mësipërm ligjvënësi ka patur për qëllim shmangien e vakumeve legjislative, që është në mbrojtje të një parimi të rëndësishëm të shtetit të së drejtës, dhe pikërisht të parimit të sigurisë juridike. Kushti që pjesa e mbetur e ligjit, në rast të një referendumi shfuqizues të jetë e vetëmjaftueshme, i shërben qëndrueshmërisë së sistemit juridik.

Në vështrim të ndalimit të mësipërm që imponon Kodi Zgjedhor, Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkesa për referendum të përgjithshëm për shfuqizimin e dispozitave të atakuara është e papranueshme.

Kështu, nga shqyrtimi i dispozitave të ligjit të kundërshtuar të vitit 2002 rezulton se, përveç ndryshimit të moshës së përfitimit të pensionit të pleqërisë, ky ligj ka sjellë ndryshime edhe në përllogaritjen e moshës dhe viteve që duhet të plotësojnë përfituesit e këtij pensioni. Pra, pavarësisht se kërkesit e kanë kufizuar kërkesën e tyre vetëm në shfuqizimin e dispozitave që kanë të bëjnë me rritjen e moshës, ky aspekt nuk mund të veçohet nga pasojat që sjell ai. Kjo do të thotë se, në rast se dispozitat që kanë sjellë rritjen e moshës për pension do të shfuqizohen me anë të referendumit, tabela përllogaritëse mbi vitet e punës dhe moshën e daljes në pension të plotë apo të parakohshëm nuk do të funksiononte më, pasi baza mbi të cilën ata përllogariteshin do të ndryshonte. Gjykata vlerëson se dispozitat që kundërshtohen janë elementë bazë të ligjit në shqyrtim, pasi, edhe sipas

⁶ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Italisë dt.12.01.1995

shpjegimeve në seancë gjyqësore të subjekteve të interesuara, ky ishte edhe qëllimi kryesor i ligjvënësit që çoi në ndryshimin e ligjit ekzistues: pra, të përpunonte një skemë të re të sigurimeve shoqërore, në themel të të cilës, kryesisht, është ulja e masës së kontributeve, si dhe rritja e numrit të kontribuesve, nëpërmjet rritjes së moshës së pensionit. Prandaj, në rast shfuqizimi me referendum të dispozitave që kanë të bëjnë me rritjen e moshës, funksionimi i kësaj skeme do të bëhej i pamundur, gjë që do të thotë se pjesa e mbetur e ligjit nuk është e vetëmjaftueshme.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa për shfuqizimin nëpërmjet referendumit të rregullimeve të reja të sigurimeve shoqërore është jokushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 152 paragrafi 1 të Kushtetutës dhe të nenit 129 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

VENDOSI :

- Deklarimin si të papajtueshme me Kushtetutën të kërkesës për zhvillimin e referendumit për shfuqizimin e neneve 4 e 6 të ligjit nr.8889, datë 25.4.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikës e Shqipërisë.”

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM

Nr.19, datë 18.11.2003

PËR PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR NDARJEN E MANDATIT TË FUNDIT PËR KËSHILLAT VENDORË MIDIS SUBJEKTEVE QË KANË NUMËR TË BARABARTË VOTASH

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe nenit 77, pika 3/b të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 77 pika 3 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Zgjedhor i Qeverisjes Vendore merr vendim për organizimin e shortit për zgjedhjen e kandidatit fitues. KZQV-ja shpall në hyrje të saj datën, vendin dhe orën e zhvillimit të shortit.

Neni 2

Shorti hidhet nga KZQV-ja në prani të subjekteve zgjedhore ose përfaqësuesve të tyre.

Neni 3

Shorti zhvillohet sipas kësaj procedure:

Në një enë vendosen dy zarfe dhe brenda njërit prej tyre në një letër format A4 është shkruar "FITUES". Shorti tërhiqet prej përfaqësuesve të dy subjekteve zgjedhore në KZQV, duke tërhequr i pari përfaqësuesi i subjektit, i cili ndodhet i renditur më lart në fletën e votimit.

Neni 4

Personi që tërheq zarfin e hap atë dhe ia dorëzon Kryetarit të KZQV-së. Kryetari lexon me zë të lartë atë çfarë përmban zarfi.

Neni 5

Rezultati i shortit pasqyrohet në procesverbal.

Neni 6

Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, KZQV-ja merr vendim për shpalljen e rezultatit të shortit.

Neni 7

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr.184/1, datë 14.11.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK "STINËT"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Sefedin Çela	Kryetar
Albert Minga	Zëvendëskryetar
Apostol Noti	Anëtar
Pashk Përvathi	Anëtar
Lazër Stani	Anëtar
Ilir Kulla	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e kërkesës për rilicencim, të paraqitur nga subjekti radiofonik "Radio Stinë", të z.Kujtim Kapollari.

Baza ligjore: Ligji nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", Rregullorja mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", vendimi nr.184, datë 31.10.2003 i KKRT-së "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik "Stinë"

VËREN:

Në mbledhjen e KKRT-së, më datë 31.10.2003 me vendimin nr.184, datë 31.10.2003 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik "Stinë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka vendosur pezullimin e procedurës së rilicencimit për transmetim radio FM vendore private "Stinë", shoqërinë "Stinë" sh.p.k. deri në zgjidhjen e problemeve ligjore midis ortakëve.

Pas njoftimit të subjektit për sa më sipër me shkresën nr.868, datë 3.11.2003, në datën 11.11.2003 u paraqit nga ana e shoqërisë "Stinë" sh.p.k. vendimi nr.17518/3, datë 10.11.2003 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, sipas të cilit ortaku Kujtim Kapollari si përfaqësues i 70% të kapitalit, në datën 5.11.2003 ka shkarkuar administratorin e shoqërisë z.Arqile Ndini, pasi në mënyrë të vazhdueshme, pa vendim të asamblesë së ortakëve ka kryer veprime në dëm të interesave

të shoqërisë. Për sa më sipër i është komunikuar z.Arqile Ndini dhe do ta njoftojë sipas ligjit për mbledhje asambleje. Deri në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, ortaku Kujtim Kapollari do të kryejë detyrën e administratorit të shoqërisë.

Bazuar në këto argumente, për kërkesën objekt shqyrtimi të paraqitur nga kërkuesi Kujtim Kapollari, KKRT-ja e gjen atë të drejtë dhe të bazuar në ligj.

PËR KËTË ARSYE,

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.008/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin "Stinët" sh.p.k. për radion "Stinët".

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2003 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM

Nr.188, datë 14.11.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK "SARANDA"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.004/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin "Media Saranda" sh.p.k. për radion "Saranda", licenca nr.004/FML.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2003 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr.189, datë 14.11.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK "NGJALLJA"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit në licencës nr.013/FML të subjektit radiofonik "Ngjallja" të emrit të subjektit të licencuar me vendimin nr.22, datë 23.10.2000 të KKRT-së, nga fondacioni "Fryma e dashurisë" në shoqëria "Radio Ngjallja" sh.p.k.
2. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas lincencës nr.013/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin "Radio Ngjallja" sh.p.k. për radion "Ngjallja".
3. Kushtet e licencës sipas pikës 2 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2003 dhe botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr.1908, me kërkesë të Vjollca Thanas vendos heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Eno Thanas, duke i caktuar si kujdestare të përkohëshme nënën e tij Vjollca Thanas.

KËRKESË

Zyra e gjendjes civile, nënprefektura Mallkastër, kërkon të shpallet i vdekur shtetasi Feçorr Malaj.

KËRKUES
Shkëlqim Shehu

KËRKESË

Zyra e gjendjes civile, nënprefektura Mallkastër, kërkon të shpallet e vdekur shtetësja Havako Zotaj.

KËRKUES
Shkëlqim Shehu

KËRKESË

Zyra e gjendjes civile, nënprefektura Mallakastër, kërkon të shpallet e vdekur shtetësja Xheke Dakaj.

KËRKUES
Shkëlqim Shehu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 18.11.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë